

**14.04.2021  
Ora 18:06**

***RENDI I DITËS***

**Projektvendimi “Për rregullat proceduriale për procesin e votimit dhe numërimit elektronik nëpërmjet pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN) në QV-të e ZAZ-së nr.40 në Qarkun Tiranë, për zgjedhjet e Kuvendit, të datës 25 prill 2021”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- **Komisioni Rregullator:**
- **Iirjana NANO Kryetar**
- **Arens ÇELA Anëtar**
- **Dritan ÇAKA Anëtar**
- **Helga VUKAJ Anëtar**
- **Muharrem ÇAKAJ Anëtar**
- **Stafi KQZ Y.Merkaj, V.Ballgjini, E.Meta, E.Allushi**
- **Parti Politike: PSD, LSI, PD**

**Znj. I. Nano:** Mirëmbërëma! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme, datë 14 prill 2021, ora 18:00. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, është i pranishëm Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe zyrtarë të tjerë të administratës së KQZ-së. Janë të pranishëm gjithashtu edhe përfaqësues të subjekteve zgjedhore të akredituara në KQZ. Sipas njoftimit të bërë lidhur me mbledhjen e sotme, në rendin e ditës janë njoftuar dy projektvendime për shqyrtim dhe miratim. I pari “Për kriteret e caktimit të numrit të grupeve të

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.04.2021*

numërimit për çdo vend të numërimit të votave, për caktimin e rregullave për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupit të numërimit, për zgjedhjet në Kuvend të datës 25 prill 2021” dhe projektvendimi “Për miratimin e udhëzuesve për mënyrën e raportimit financiar nga partitë politike, kandidatët e listave shumëmemërore dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për fushatën zgjedhore, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë”. Ndërkohë në mbledhjen e kaluar të datës 12 prill, kishim në rendin e ditës disa projektvendime. Lidhur me një nga projektvendimet me kërkesë të njërit prej anëtarëve të Komisionit Rregullator dhe me miratimin e të gjithë anëtarëve, u vendos shtyrja e shqyrtimit të tij bazuar në nenin 24, pika 3 të rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Rregullator”. Gjithashtu sipas të njejtës dispozitë të rregullores ky projektvendim i cili u shty për shqyrtim, duhet të shqyrtohet në mbledhjen më të afërt e cila është sot. Pra, veç dy projektvendimeve të reja kemi edhe një projektvendim të shtyrë nga mbledhja e kaluar, bëhet fjalë pikërisht për projektvendimin “Për rregullat procedurale për procesin e numërimit dhe votimit elektronik nëpërmjet pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN), në qendrat e votimit të zonës së administrimit zgjedhor numër 40, në Qarkun Tiranë, për zgjedhjet e Kuvendit të datës 25 prill 2021. Kolegë jeni dakord me këtë renditje, pra që të shqyrtojmë së pari projektaktin e shtyrë nga mbledhja e kaluar dhe pastaj projektaktet e përgatitura për mbledhjen e sotme?

**Paneli i Rregullatorit:** – Po dakord!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit! Atëherë nisim me projektaktin që sapo lexova, “Për rregullat procedurale..”, po po, faleminderit zoti Çakaj! Për procedurë nëse ndonjë nga kolegët kanë çështje jashtë rendit të ditës. Zonja Vukaj?

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.04.2021*

**Znj. H. Vukaj:** Kisha një çështje jashtë rendit të ditës, kështu që, po adresoj në momentin e duhur, faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Po zoti Çakaj?

**Z. M. Çakaj:** Edhe unë!


**Znj. I. Nano:** Dakord! Pasi të përfundojmë diskutimet për çështjet e rendit të ditës, kemi çështje jashtë rendit të ditës sipas kësaj rradhe. Zonja Vukaj, zoti Çakaj. Faleminderit! Atëherë fillojmë me projektaktin e parë. Po, vetëm shkëputemi 2 minuta atëherë sa të..,

**Z. M. Çakaj:** Po mund të vazhdojmë me çështjet jashtë rendit të ditës, t'i zhvillojmë tani edhe,

**Znj. I. Nano:** Jo nuk ka gjë, i lamë për në fund, mos.., Zoti Merkaj jeni gati për të filluar me prezantimin e projektaktit për rregullat proceduriale për procesin e numërimit dhe votimit elektronik nëpërmjet pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN), në QV-të e ZAZ-së numër 40, në Qarkun Tiranë, për zgjedhjet e Kuvendit të datës 25 Prill 2021". Faleminderit!

**Z. Y. Merkaj:** Neni 20 i Kodit Zgjedhor, parashikon kompetencën e Komisionit Rregullator për miratimin e rregullave të përdorimit të sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit, të domosdoshme për të siguruar përdorimin e ligjshëm të rregullave transparente, efikase dhe të qëndrueshme të tyre, për përdorimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit për të mbuluar aspekte apo procedura të veçanta të procesit zgjedhor ose heqjen e tyre nga përdorimi. Gjithashtu neni 22 pika 1 e Kodit Zgjedhor, përcakton kompetencën e Komisionit

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.04.2021*

Qendror të Zgjedhjeve, të eksperimentojë dhe të vendosë në përdorim të zgjedhjeve, të sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit, për të mbuluar aspekte apo procedura të veçanta të këtij procesi zgjedhor. Përdorimi i sistemeve apo i pajisjeve të teknologjisë së informacionit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, është i detyruar të zbatojë zgjedhjet nëpërmjet projekteve pilot në jo më pak se 10 përqind të numrit të zgjedhësve në çdo fazë të implementimit. Pika 3 e nenit 21 të Kodit Zgjedhor, përcakton përdorimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit, që bëhet në përputhje me rregullat e posaçme lidhur me procedurën për aspekte të veçanta të procesit që mbulohe nga sistemi apo pajisje të teknologjisë së informacionit. Rregullat proceduriale për këtë qëllim miratohen me akt normativ të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në datën 02.03.2021, ka miratuar me vendimin numër 111, caktimin e ZAZ-së numër 40, në Bashkinë Tiranë si njësi administrative për zbatimin e projektit pilot për procesin e votimit dhe numërimit elektronik të votave në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Me qëllim implementimin e këtij projekti pilot në zonën e administrimit zgjedhor, çmohet se duhet të miratohen rregulla nga Komisioni Rregullator që janë rregulla të posaçme lidhur me procedurat për aspekte të veçanta të procesit që mbulohe nga sistemi apo pajisje të teknologjisë së informacionit. Qëllimi i këtij projektvendimi është përcaktimi i rregullave proceduriale në mënyrë sesi do të implementohet projekti pilot dhe do të vlerësohet efektshmëria dhe efikasiteti i tij. Projektvendimi përmban 18 pika, duke përcaktuar numrin e pajisjeve që do të përdoren në çdo qendër votimi, gjithashtu për shkak të dinamikës së procesit zgjedhor dhe ndërveprimit të rregullave proceduriale standarte dhe pamundësisë për të evidentuar në detaje problematikat dhe risqet që mund të shoqërojnë implementimin e këtij projekti pilot autorizohet Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, të udhëzojë administratën zgjedhore, të ZAZ-së numër 40, për të gjitha veprimtaritë operationale për dorëzimin e bazës materiale apo proceduriale

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.04.2021*

që automatizon për shkak të implementimit të kësaj teknologjie. Projektvendimi parashikon edhe mundësinë e udhëzimit operacional të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në varësi të situatave që diktohen nga dinamika e procesit. Në projektakt është parashikuar që KZAZ-ja, i dorëzon komisionit të qendrës së votimit vetëm materialet zgjedhore dhe PEVN-në, është pajisja e votimit elektronik dhe kutinë shoqëruese e cila do të mundësojë votimin elektronik. Gjithashtu për të garantuar të drejtat e zgjedhësve me aftësi të kufizuar është parashikuar dhe e drejta ligjore e votimit e cila do të ndihmohet nga një familjar ose një zgjedhës që është i kësaj qendre votimi. Është parashikuar që SEMV-ja, sistemi do të kryejë përlogaritjen e rezultateve do të shfaqet në monitor dhe do të printojë në letër tabelat e rezultave për çdo qendër votimi si dhe tabelën përmbledhëse të rezultateve për zonën e administrimit zgjedhor sipas modeleve të miratuara nga Komisioneri. Në projektvendim është parashikuar që tabelat e rezultateve si për qendrat e votimit ashtu dhe për ZAZ-në, do të firmosen nga anëtarët e komisionit zonal të administrimit zgjedhor. Tabela përmbledhëse e rezultatit do të miratohet me vendim nga KZAZ-ja. Është parashikuar edhe rregulli në rastet kur procedura e votimit është zhvilluar në një pjesë të ditës me numërime elektronike dhe në pjesën tjetër është zhvilluar manualisht. Grupi i numërimit të votave ndjek procedurën standarte për hapjen e kutive të votimit sipas udhëzimit të KQZ-së, vetëm pasi sistemi ka gjeneruar raportin me rezultatet e votimit për pjesën elektronike. Me qëllim të edukimit të zgjedhësve për votimin elektronik, është parashikuar vendosja e pajisjeve stimuluese me të dhëna ilustruese që vendosen në çdo qendër votimi dhe për t'u ardhur në ndihmë zgjedhësve. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zoti Merkaj! Atëherë çelim diskutimin në parim për projektvendimin, në këtë fazë të procedurës fjalën e kanë së pari anëtarët e

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.04.2021*

Komisionit Rregullator më tej përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore. Kolegë?  
Nëse nuk ka diçka lidhur me diskutimin në parim lidhur me këtë projektvendim,  
ju ftoj të kalojmë në votimin në parim të projektvendimit,

***Kush është dakord në parim me projektvendimin e paraqitur nga Komisioneri?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundra: S'ka***

Me 5 vota pro miratohet!

Në fazën tjetër të procedurës kur do të kalojmë nën për nën ftoj përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore, nëse do të kenë diçka për nën apo pika të caktuara të projektvendimit, të kërkojnë fjalën, faleminderit! Fillojmë me:

**Pikën 1:** Çdo qendër votimi QV, në zonën e administrimit zgjedhor, ZAZ numër 40 të Qarkut Tiranë, të ketë 2 pajisje elektronike të votimit dhe numërimin PEVN, që mundësojnë votimin elektronik në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021. Ka ndonjë diskutim, pyetje, komente, apo propozime për shtesa apo ndryshime në këtë pikë? Nëse jo kalojmë në votimin e pikës 1,

***Kush është dakord kolegë?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundra: S'ka***

Me 5 vota pro miratohet!

**Pika 2:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, udhëzon anëtarët e KZAZ-së dhe KQV-ve nën juridiksionin e saj për veprimtaritë operationale, që lidhen me marrjen në dorëzim dhe kthimin e bazës materiale zgjedhore.

Diskutime? Nuk ka. Kalojmë në votim. Votojmë pikën 2, sipas përmbajtjes së propozuar nga Komisioneri.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundra: S'ka***

Me 5 vota pro miratohet!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.04.2021*

**Pika 3:** KQV për procedura të cilat nuk janë të automatizuara, zbaton rregullat e përcaktuara në vendimin numër 11, datë 25 mars 2021, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e ngritjes, organizimit dhe funksionimit të qendrës së votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në qendrën e votimit”, ndërsa për procedurat e automatizuara vepron në përputhje me udhëzimet operacionale të Komisionerit. Përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore? Kolegë? Zoti Çaka?

**Z. D. Çaka:** Doja thjesht një, të themi saktësim aty ku është shprehur fjala termi “Komisioneri” të plotësohet me Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

**Znj. I. Nano:** Dakord! Kjo është për t’u rregulluar besoj gjatë zbardhjes, nuk është ndryshim i propozuar, i lutem administratës. Atëherë, meqë nuk ka diskutime të tjera kalojmë në votimin e pikës 3.

**Kush është dakord ju lutem kolegë?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)


**Kundra:** S’ka

Me 5 vota pro miratohet!

**Pika 4:** KZAZ-ja i dorëzon KQV-së, vetëm materialet zgjedhore dhe PEVN-të, pra pajisjet elektronike të votimit dhe të numërimit me kutitë shoqëruese, të cilat mundësojnë votimin elektronik. Kemi diskutime, komente? Zoti Çaka?

**Z. D. Çaka:** Po atëherë, në lidhje me pikën 4, ajo çfarë unë do të propozoja lidhet edhe me pikën 5 po të këtij projektvendimi. Në pikën 4 të këtij projektvendimi është përcaktuar që KZAZ-ja do të dorëzojë në Komisionin e Qendrës së Votimit vetëm ato materiale zgjedhore dhe PEVN-në, që ka të bëjë me votimin elektronik ndërkohë që në pikën 5 është përcaktuar një rast i veçantë, pra i ndryshëm nga e përgjithshmja që kryetari apo një anëtar dhe sekretari i KZAZ-së, dërgojnë në

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.04.2021*

qendrën e votimit, kutinë me fletët e votimit, vetëm në rast se Komisioneri vendos të vijojë procedurën me fletë votimi dhe sipas vlerësimit të situatës. Pra, ajo çfarë është sjellë si propozim, është fakti që nëse për ndonjë arsye ose në vlerësim të situatës së Komisionerit, pajisjet nuk do të funksionojnë atëherë do të kalojë në një votim manual dhe në këtë rast, në ditën e zgjedhjeve KZAZ-ja, do të dërgojë kutitë me materiale, kutitë dhe me fletët e votimit. Por, besoj që kjo mundet edhe të kishte një zgjatje të procesit të pezullimit në atë QV dhe unë do të propozoja që në pikën 4, fletët e votimit së bashku më kutitë e votimit të merreshin një ditë më parë nga Komisioni i Qendrës së Votimit, të mbaheshin në Komisionin e Qendrës së Votimit, në mënyrë absolute mos të prekeshin nga anëtarët e Komisionit të Qendrës së Votimit ditën e zgjedhjeve, pa ardhur një vendimarrje dhe një udhëzim nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Kjo besoj që do të ndihmonte ose do të jepte kohë më të shumtë votuesve që të votonin në qendrën e votimit dhe të mos kemi pezullim të mëtejshëm. Mbase u zgjata pak në të arsyetuar dhe do të kaloja në propozimin konkret dhe të pikës 4 dhe të pikës 5 në këtë rast, sepse ato shkojnë në mënyrë kolaterale.

**Znj. I. Nano:** Mirë, nëse miratojmë pikën 4, propozimin tuaj, atëherë besoj ka vend edhe propozimi në pikën 5.

**Z. D. Çaka:** Po, dakord! Në pikën 4 unë propozoj që ajo të riformulohet si më poshtë:

KZAZ-ja i dorëzon KQV-së:

- a. Materialet zgjedhore të përcaktuara në nenin 18 të vendimit numër 11, datë 25.03.2021, të Komisionit Rregullator.
- b. PEVN-në, me kutitë shoqëruese të cilat mundësojnë votimin elektronik.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.04.2021*

**Znj. I. Nano:** Pra, ideja juaj është që, KZAZ-ja 40 t'i dorëzojë çdo KQV-je në juridiksionin e saj çdo material sikundër merr çdo KQV nga çdo KZAZ në Republikën e Shqipërisë, për këto zgjedhje.

**Z. D. Çaka:** Po!

**Znj. H. Vukaj:** Një sqarim zoti Çaka, në funksion të kësaj që ju nxitët apo po propozoni, mendoj të sqarojmë, ju bëtë arsyetimin tuaj por mendoj të sqarojmë që zëvendësimi në rast se do të ndodhë prishja e aparaturës së parë, ekziston mundësia e aparaturës së dytë dhe mesa kuptova ju këtë e bëni për fleksibilitet dhe për ekonomikitet, të asaj dite dhe të procesit të votimit, apo jo?

**Z. D. Çaka:** Po kjo bëhet vetëm për.., që në ditën e votimit të kemi një fleksibilitet, pra që të mos jetë atë ditë që të bëhen të gjithë lëvizjet e një pjese të bazës materiale dhe absolutisht po në përgjigje të asaj që ju ngritët edhe pasi të kenë dështuar mundësitë e dyta, 2 provat..,

**Znj. H. Vukaj:** 2 provat e 2 makinerive?

**Z. D. Çaka:** Patjetër, absolutisht.

**Znj. H. Vukaj:** Që ka gjasa dhe probabiliteti është jashtëzakonisht i vogël, për mos thënë absolutisht fare,

**Z. D. Çaka:** Patjetër, absolutisht edhe pasi ka dështuar, pra mundësia e dytë për ta zëvendësuar dhe gjithmonë vetëm me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.04.2021*

**Znj. H. Vukaj:** Faleminderit! E qartë! Dakord! Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Para se të kalojmë në votim zoti Çaka, mundet ta riformuloni edhe njëherë propozimin tuaj ose ta thoni edhe njëherë për të mbajtur shënim!

**Z. D. Çaka:** Po. Atëherë pika 4: KZAZ-ja i dorëzon KQV-së:

- a. Materialet zgjedhore të përcaktuara në nenin 18 të vendimit numër 11, datë 25.03.2021, të Komisionit Rregullator.
- b. PEVN-në, me kutitë shoqëruese që mundësojnë votimin elektronik.

**Znj. I. Nano:** Dakord! Votojmë propozimin e zotit Çaka, për riformulimin e pikës 4 ju lutem?

**Kush është dakord kolegë?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Atëherë vijmë në **pikën 5:** Kryetari apo një anëtar i propozuar nga e njëjta forcë politike me kryetarin dhe sekretari i KZAZ-së, dërgojnë në QV, kutinë me fletët e votimit vetëm në rast se Komisioneri vendos të vijojë procedurën e votimit me fletë votimi sipas vlerësimit të situatës nga ana e tij.

Zoti Çaka së paku ka propozim, sepse e lidhi atë me pikën 4, ndërkohë nëse ka propozime të tjera pas zotit Çaka, mundet të..,

**Z. D. Çaka:** Po, në kushtet kur ne si Komision votuam dhe miratuam pikën 4, që fletët e votimit megjithë kutinë e votimit mos të shkonin ditën e zgjedhjeve por një ditë më para të merreshin në dorëzim nga KQV-ja. Gjykoj që pika 5 ka nevojë për riformulim dhe të bëhet e tillë "Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendos të vijojë procedurën e votimit me fletë votimi, sipas vlerësimit të situatës nga ana e

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.04.2021*

tij". Pra, të jetë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ai që do të normojë momentin e fillimit të kësaj procedure dhe aspak Komisioni i Qendrës së Votimit.

**Znj. I. Nano:** Dakord! Ka diskutime apo propozime të tjera? Nëse jo, votojmë propozimin e zotit Çaka për rifomulimin e pikës 5: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendos të vijojë procedurën e votimit me fletë votimi, sipas vlerësimit të situatës nga ana e tij.

**Kush është dakord ju lutem?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Kalojmë në **pikën 6:** Zgjedhësi që për arsye fizike nuk është në gjendje të kryejë vetë procedurat e votimit, mund të kërkojë ndihmën e një familjari ose zgjedhësi tjetër, që është në listën e zgjedhësve të asaj zone të qendrës së votimit. Të dy zgjedhësit duhet të jenë të pranishëm në qendrën e votimit kur përdoret kjo procedurë. Një person mund të ndihmojë vetëm një zgjedhës që nuk mund të votojë vetë. Në fakt është e njëjta dispozitë që përdoret edhe në rastin e votimit manual. Gjithsesi nëse ka komente, pyetje apo propozime? Nuk ka, kalojmë në votimin e pikës 6.

**Kush është dakord me pikën 6, sipas propozimit të ardhur?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka


Me 5 vota pro miratohet!

**Pika 7:** Procesi i nxjerrjes së rezultateve për çdo QV dhe në rang ZAZ-je drejtohet nga KZAZ-ja numër 40 në ambjentin e VNV-së, së përcaktuar nga KQZ. Ka ndonjë koment, propozime? Jo! Atëherë kalojmë në votimin e pikës 7?

**Kush është dakord kolegë?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.04.2021*

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro miratohet pika 7!

**Pika 8:** Pas mbylljes së votimit, KQV-të çojnë pranë VNV-së numër 40, pajisjet PEVN, së bashku me materialet e tjera zgjedhore. Komente, propozime, pyetje nuk ka? Kalojmë në votimin e pikës 8.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

**Pika 9:** Pas dorëzimit nga të gjitha KQV-të pranë KZAZ-së, të pajisjeve dhe materialeve përkatëse, KZAZ-ja mbyll ambjentin ku do të kryhet numërimi dhe rifillon punën për nxjerrjen e rezultateve të nesërmen e ditës së votimit. Gjatë natës ambjenti vëzhgohet me kamera të cilat sigurojnë regjistrimin dhe transmetimin e pamjeve gjatë gjithë kohës në serverin e KQZ-së. KQZ-ja u mundëson subjekteve zgjedhore, me kërkesë të tyre të shikojnë nga pajisjet e tyre pamjet e ambjentit ku ruhen materialet zgjedhore.

Komente, pyetje, diskutime, propozime për shtesa apo ndryshime? Po zoti Çela?

**Z. A. Çela:** Faleminderit! Kam një propozim për një formulim të pikës 9. Atëherë, "Pas dorëzimit nga të gjitha KQV-të pranë KZAZ-ve të pajisjeve dhe materialeve përkatëse KZAZ-ja mbyll ambjentin ku do të bëhet numërimi", dhe të shtohet, "Rezultatet do të shpallen të nesërmen e ditës së votimit, ora 8:00". Pastaj komplet pjesa tjetër vazhdon..,

**Znj. I. Nano:** ..gjatë natës ambjenti vëzhgohet me kamera.

**Z. A. Çela:** Po, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.04.2021*

**Znj. I. Nano:** Parimisht edhe unë e mbështes propozimin tuaj për të patur një nxjerrje rezultati sa më shpejt të jetë e mundur, sepse formulimi sipas propozimit që na ka ardhur është dita e nesërme e ditës së votimit, që do të thotë deri në orën e 24 të ditës së nesërme. Kështu që duke vendosur një orar për nxjerrjen e rezultatit, KZAZ-ja mundet ta menaxhojë punën e vet për ta nxjerrë. Nuk e di kolegët, nëse kanë ndonjë koment apo sugjerim tjetër, ka ndonjë propozim tjetër lidhur me këtë pikë?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Ora 8 e mëngjesit në këtë rast ishte propozimi?

**Znj. I. Nano:** Po! Atëherë, nëse nuk ka propozime të tjera, kalojmë në votimin e propozimit të zotit Çela? Pra, propozimi i zotit Çela është riformulim i pikës 9. “Pas dorëzimit nga të gjitha KQV-të pranë KZAZ-së të pajisjeve dhe materialeve përkatëse, KZAZ-ja mbyll ambjentin ku do të kryhet numërimi..”. Më tej, “..Rezultati do të shpallet të nesërmen e ditës së votimit, ora 8:00” . Në ora 8 nënkupton 8 të mëngjesit. “Gjatë natës ambjenti vëzhgohet me kamera”. Vijon, siç ka qenë fjalia e fundit e kësaj pike. Kalojmë në votimin e pikës 9, me propozimin e zotit Çela.

**Kush është dakord kolegë, për nxjerrjen e rezultatit në orën 8 në mëngjes?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S’ka

Me 5 vota pro miratohet!

**Pika 10.** KZAZ-ja nr.40 në prani të vëzhguesve kryen procesin e numërimit të votave në sistemin elektronik të menaxhimit të votimit dhe rezultateve SEMVR sipas procedurave teknike dhe operacionale të përcaktuara në dinamikë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.04.2021*

Kemi komente, pyetje, diskutime, propozime për këtë pikë? Nëse jo, kalojmë në votimin e pikës 10.

***Kush është dakord me pikën 10 sipas përmbajtjes së propozuar nga Komisioneri?***

***Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundra: S'ka***

Me 5 vota pro miratohet!

**Pika 11.** SEMVR do të kryejë përlllogaritjen e rezultatit dhe do të shfaqë në monitor e do të printojë në letër tabelat e rezultateve për çdo QV, si dhe tabelën përmbledhëse të rezultateve për ZAZ-në, sipas modeleve të miratuara nga Komisioneri. Personalisht do të shtoja, “Shtetëror i Zgjedhjeve” në secilin rast. Kemi ndonjë diskutim apo propozim për pikën 11? Nëse jo, kalojmë në votimin e pikës 11.

***Kush është dakord të nderuar kolegë?***

***Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundra: S'ka***

Me 5 vota pro miratohet pika 11!

**Pika 12.** Tabelat e rezultateve si për QV-në dhe për ZAZ-në firmosen nga anëtarët e KZAZ-së. Tabela përmbledhëse e rezultateve miratohet me vendim nga KZAZ-ja. Kemi ndonjë propozim, ndonjë koment? Nëse jo, kalojmë në votimin e pikës 12.

***Kush është dakord ju lutem?***

***Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundra: S'ka***

Me 5 vota pro miratohet pika 12!

**Pika 13.** Në rastin kur procedura e votimit të zhvilluar në njërin pjesë të ditës elektronikisht dhe në një pjesë tjetër të ditës është zhvilluar manualisht, GNV ndjek procedurat standarte për hapjen e kutive të votimit sipas udhëzimeve të

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.04.2021*

KQZ-së, vetëm pasi sistemi ka gjeneruar raportin me rezultatet e votimit për pjesën elektronike. Keni ndonjë propozim, zoti Kaziaj, kolegë? Nëse jo, kalojmë në votimin e pikës 13.

***Kush është dakord ju lutem?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundra: S'ka***

Me 5 vota pro miratohet!

**Pika 14.** Administrata e KQZ-së në godinat ku janë të vendosura qendrat e votimit, vendos pajisje simuluese me të dhëna ilustruese me qëllim, edukimin dhe informimin e zgjedhësve për mënyrën e votimit elektronik dhe harton pyetësor për të vlerësuar përshtypjet e zgjedhësve lidhur me përdorimin e teknologjisë në zgjedhje. Komente, pyetje, diskutime, propozime konkrete nuk ka? Votojmë pikën 14.

***Kush është dakord ju lutem me pikën 14?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundra: S'ka***

Me 5 vota pro miratohet!

**Pika15.** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve kujdeset për informimin e zgjedhësve dhe të administratës zgjedhore në lidhje me përdorimin e PEVN-së. Ka ndonjë propozim për ndryshime, shtesa, nuk ka?

***Atëherë kalojmë në votimin e pikës 15, kush është dakord?***


***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundra: S'ka***

Me 5 vota pro miratohet!

**Pika 16.** Në përfundim të pilotimit të procesit të votimit elektronik dhe pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve harton një raport analitik mbi gjetjet dhe efektshmërinë e përdorimit të teknologjisë në KZAZ-në nr.40, Qarku Tiranë. Zoti Çaka?

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.04.2021*

**Z.D.Çaka:** Atëherë, mbase është dhe një pyetje për administratën. Kur themi në përfundim të pilotimit të procesit të votimit, mos duhet shtuar, jo vetëm votimit por dhe numërimit? Pra, që të jenë të dy, besoj që ky raport analitik që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve do të bëjë, do të jetë për të dyja fazat, dhe për të votimit dhe të numërimit besoj?

**Znj.I.Nano:** Atëherë, duke qenë që është një shtesë, në këtë rast, në përfundim të procesit, “në përfundim të pilotimit të procesit të votimit dhe numërimit elektronik..”, thotë zoti Çaka, do të duhet ta konsiderojmë propozim për t’u votuar. Ka ndonjë propozim tjetër? Nëse jo, votojmë propozimin e zotit Çaka, që pas fjalës, “votimit”, të shtohet, “dhe numërimit”, dhe vijon siç ishte, dhe numërimit elektronik. Kalojmë në votimin e këtij propozimi.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S’ka

Me 5 vota pro miratohet!

**Pika 17.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

**Kolegë, ju ftoj të votojmë pikën 17.**

**Pro:** 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S’ka

Me 5 vota pro miratohet!


**Pika 18.** Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S’ka

Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.04.2021*

Me 5 vota pro miratohet!

Kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit, pasi e kemi votuar në parim dhe në çdo pikë të tij, ka pësuar disa ndryshime.

***Kush është dakord në tërësi me projektvendimin?***


***Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundra: S'ka***

Me 5 vota pro sapo kemi miratuar vendimin për rregullat proceduariale për procesin e votimit dhe numërimit elektronik nëpërmjet pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit në QV-të e ZAZ-së nr.40, në Qarkun Tiranë për zgjedhjet e Kuvendit të datës 25 Prill 2021.

**Vendimi nr.17**

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**



**RENDI I DITËS**

Projektvendimi “Për miratimin e udhëzuesve për mënyrën e raportimit financiar nga partitë politike, kandidatët e listave shuumëmërore dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për fushatën zgjedhore, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”.

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

• **Komisioni Rregullator:**

1.Ilirjana	NANO	Kryetar
2.Arens	ÇELA	Anëtar
3.Dritan	ÇAKA	Anëtar
4.Helga	VUKAJ	Anëtar
5.Muharrem	ÇAKAJ	Anëtar

• **Stafi** KQZ Y.Merkaj, V.Ballgjini, E.Meta

**Parti** Politike: LSI, PSD, PD

**Znj.I.Nano:** Kalojmë në projektvendimin e dytë, sipas rendit të ditës ose nëse ju dëshironi, unë përpara kam projektvendimin për miratimin e udhëzuesve për mënyrën e raportimit financiar nga partitë politike, kandidatët e listave shumëmërore dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për fushatën zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë. Ky projektvendim, në fakt do ta prezantojë sekretari i Përgjithshëm, po vjen në vijim edhe të një vendimmarrjeje të mëhershme të Komisionit Rregullator për rregullat e raportimit financiar për këto subjekte që janë parashikuar partitë politike, kandidatët e listave shumëmërore dhe kandidatët e propozuar për zgjedhësit, bëhet fjalë për

Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.04.2021*

raportimin për fushatën zgjedhore. Zoti Merkaj, mundet ju lutem të prezantoni projektaktin? Faleminderit!

**Z.Y.Merkaj:** Atëherë, neni 92/1 i Kodit Zgjedhor parashikon financimin e subjekteve zgjedhore nga fondet jopublike, kufizimet dhe dhurimet që çdo person juridik apo fizik vendas mund të japë në subjektin zgjedhor, si dhe ndalimin e fondeve nga një person juridik apo çdo aksioner i tij, nëse ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor. Neni 32/2 i Kodit Zgjedhor përcakton regjistrimin e fondeve jopublike nga çdo subjekt zgjedhor, i cili do të regjistrojë në regjistër të posaçëm, të miratuar me vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve shumën e fondeve të përfituara nga çdo person fizik apo juridik, si dhe të dhënat e tjera që lidhen me identifikimin e qartë të dhuruesit, huadhënësit apo kredidhënësit, nënshkrimin e deklaratës, e cila nënshkruhet në çastin e dhurimit apo të hapjes dhe deklarimit, të llogarisë së posaçme nga subjekti zgjedhor, kandidatët e listës shumëemërore apo kandidatët e propozuar nga zgjedhësit. Projektvendimi ka për qëllim përcaktimin e një përmbledhjeje të bazës ligjore dhe kërkesave që rregullojnë financimin e fushatës zgjedhore për partitë politike, kandidatët e listës shumëemërore apo kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe jep udhëzime për mënyrën e plotësimit të formularit tip të raportimit të financimit të fushatës zgjedhore nga partitë politike, kandidatët e listës shumëemërore apo kandidatët e propozuar nga zgjedhësit. Projektvendimi nëpërmjet shembujve konkretë pasqyron mënyrën e saktë të plotësimit të formularëve tip të raportimit financiar të fushatës zgjedhore nga partitë politike, kandidatët e listave shumëemërore apo kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe afatet e dorëzimit të tyre. Në funksion të këtij qëllimi janë përgatitur 3 udhëzues përkatësisht, udhëzuesi për raportimin e partive politike, udhëzues për mënyrën e raportimit financiar për kandidatët e listave shumëemërore, si dhe udhëzuesit për raportimin financiar nga kandidatët e propozuar nga zgjedhësit. Udhëzuesit janë ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë paraqet një pasqyrë të kuadrit

*Zbardhi materialin audio*

**Lorena KONJA**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.04.2021*

ligjor që rregullon aspektet e financimit të fushatës zgjedhore, ndërsa pjesa e dytë ofron udhëzime për mënyrën e plotësimit të formateve të raportimit financiar. Në pjesën përbërëse të këtyre udhëzuesve janë të gjitha shpjegimet e nevojshme që kanë të bëjnë me seksionet kryesore të formatit tip të raportimit si më poshtë. Informacioni për subjektet zgjedhore, pasqyrat financiare dhe gradat, të ardhurat nga fondet publike, të ardhurat nga dhurimet monetare jopublike private, të ardhurat nga dhurimet në natyrë jopublike, të ardhurat e krijuara nga vetë subjektet zgjedhore, kreditë dhe borxhet e tjera, shpenzimet e kryera nga partia, raportet e kandidatëve, si dhe shpenzimet për mitingje në fushatë. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

**Znj. I.Nano:** Faleminderit zoti Merkaj. Në fakt, sikundër unë e theksova më herët, ky projektvendim që po shqyrtojmë sot vjen pasi ne si Komision Rregullator në datën 6 prill, me vendim nr.13 kemi miratuar ose kemi përcaktuar rregullat për raportimin financiar të subjekteve zgjedhore, kontrolli dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore dhe kemi orientuar që këto rregulla lidhen me: Partitë politike kur konkurrojnë më vete, apo si pjesë e një koalicioni, përfshirë kandidatët e tyre, si dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit. Pra le të themi, cilat janë subjektet që kanë detyrimin të kryejnë raportimin financiar për financimin e fushatës zgjedhore janë miratuar më herët dhe janë 3 kategori. Janë partitë politike, qoftë kur konkurrojnë më vete, qoftë kur konkurrojnë në kuadër të një koalicioni, janë kandidatët e tyre të listave shumëemërore, janë dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit. Kështu që në këtë projektvendim na vijnë për miratim 3 udhëzues për mënyrën sesi do të kryhet raportimi financiar nga partitë politike nëpërmjet 3 shtojcave. Atëherë, kolegë nëse keni diçka në parim me projektvendimin? Nëse jo, kalojmë në miratimin në parim të projektvendimit.

***Kush është dakord ju lutem, në parim?***

*Zbardhi materialin audio*

**Lorena KONJA**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.04.2021*

**Pro:** 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Kalojmë nen për nen ose pikë për pikë.

**Pika 1.** Komisioni Rregullator vendosi:

1. Miratimin e udhëzuesve për mënyrën e raportimit financiar nga partitë politike, kandidatët e listave shumëemërore dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për fushatën zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë si vijon.

a. Udhëzues për mënyrën e raportimit financiar nga partitë politike sipas shtojcës 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b. Udhëzues për mënyrën e raportimit financiar nga kandidatët e listave shumëemërore sipas shtojcës 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

c. Udhëzues për mënyrën e raportimit financiar nga kandidatët e propozuar nga zgjedhësit sipas shtojcës 3 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Kolegë, ju ftoj të diskutojmë dhe më tej të kalojmë në miratimin e pikës 1, pasi nëpërmjet miratimit të pikës 1, miratojmë të 3 udhëzuesit që janë shtojca bashkëlidhur vendimit, kështu që edhe nëse kemi diçka lidhur me shtojcat, është momenti për ta diskutuar tani. Zoti Çakaj!

**Z.M.Çakaj:** Po, faleminderit e nderuar! Atëherë, në fakt udhëzuesi për mënyrën e raportimit financiar nga partitë politike nga kandidatët e listave shumëemërore dhe nga kandidatët e propozuar nga zgjedhësit është një material voluminoz. Ai është një material i detajuar, i cili orienton gjithë financierët e partive politike, por edhe kandidatët e tyre për mënyrën e raportimit të shpenzimeve të tyre financiare, por edhe për të qartësuar gjithë kandidatët, atë çfarë parashikime ka Kodi Zgjedhor, si dhe çfarë parashikime kemi miratuar ne me aktin pararendës. Ajo çfarë do të doja unë, pasi i kam lexuar dhe shqyrtuar në tërësi të gjitha këto 3 udhëzime të përmbledhura në një material udhëzues të unifikuar, nisur edhe nga fakti se nuk del e qartë në Kodin Zgjedhor, lidhur me burimet vetjake të

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.04.2021*

financimit të kandidatëve të listave shumëemërore, por lidhur edhe me financimin nga burime vetjake të kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ta shikojë në vendin përkatës, ta implementojë propozimin konkret. Atëherë unë propozoj konkretisht që të shtohet në udhëzimin nr.2, në mos gaboj, ky përcaktim, “Detyrimet e kandidatit të listave shumëemërore për vetëfinancimin e fushatës së tij, do zbatohen të njëjta, siç parashikohet në nenin 92/1, pika 2 e ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë dhe në udhëzimin nr.3, për financimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit do të bëja të njëjtin propozim, pra, detyrimet e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit për vetëfinancimin e fushatës së tij do të zbatohen të njëjta, siç parashikohet në nenin 92/1, pika 2 e Kodit Zgjedhor.

**Znj.I.Nano:** Zoti Çakaj, faleminderit! Parimisht jam dakord me propozimin tuaj dhe po kërkoja në shtojcën 2 dhe 3, pikërisht vendin ku do ta vëmë, sepse janë parashikuar dhe në shtojcën 2 dhe 3 në rastin e kandidatëve të listave shumëemërore dhe në rastin e kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit, cilat janë burimet e financimit dhe një prej tyre është financimi nga burime vetjake të subjektit të subjektit zgjedhor, kështu që, referimi konkret nga ana juaj personalisht duket jo thjesht korrekt, por i nevojshëm për t’u vendosur.

**Z.M.Çakaj:** Ideja është këtu, që të ndiqet i njëjti standard për vetëfinancimin njësoj si financimi nga donacionet nga subjektet e tjera. Pra, së pari është detyrimi për ta regjistruar në një llogari të posaçme bankare, kur kalon shumën 50 mijë lekë, por edhe shumat nën 50 mijë lekë, nëse do të kalojnë nëpërmjet bankës, duhet posaçërisht të lëvrohen nëpërmjet kësaj llogarie të posaçme dhe së dyti, është dhe tavan i financimit, që është jo më shumë se 1 milion lekë, përndryshe do të quhej financim i paligjshëm, pra i njëjti standard parashikohet edhe për kandidatët dhe financimin e kandidatëve të listave shumëemërore të partive

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.04.2021*

politike apo koalicionet e partive politike, por edhe për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, faleminderit!

**Znj.I.Nano:** Faleminderit, kolegë! Kemi propozime të tjera?

**Znj.H.Vukaj:** Kam diçka për të shtuar. Në fakt jo propozim, bie dakord me çfarë propozoi kolegu, por duke qenë që akti është voluminoz dhe këtu s'kemi kohën e mjaftueshme që të ndalemi sepse duket tepri, në momentin që po kalojmë, të ndalemi në çdo gabim ortografik apo në çdo ekuivalentim të fjalëve në një kuptim juridik, apo sipas Kodit, Atëherë do t'i lutesha administratës që në evidencat që kemi mbajtur apo evidentimin e gabimeve që kemi mbajtur të na referohet përpara se ta printojë apo ta bëjë gati për publikim, faleminderit!

**Znj.I.Nano:** Atëherë, nëse nuk kemi propozime të tjera, lutem votojmë propozimin e zotit Çakaj, ndërkohë edhe unë kam një propozim, po për këtë nen, por të votojmë propozimin tuaj njëherë zoti Çakaj. Atëherë votojmë propozimin e zotit Çakaj për të shtuar te udhëzuesi sipas shtojcës 2 dhe udhëzuesit sipas shtojcës 3. Pikërisht te burimet e financimit vetjak të kandidatit, atë që propozoi zoti Çakaj për kufijtë e financimit dhe referencën konkrete në Kod.

**Kush është dakord kolegë?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Propozimi im që ndoshta nuk është një propozim për t'u votuar, gjithashtu lidhet me disa formulime, veçanërisht do të doja që të harmonizohej në terminologji. Këto manuale, këto shtojca me vendimin që sapo cituam, me vendimin nr.13, datë 6 prill, pra për të saktësuar subjektet që kanë detyrimin e raportimit financiar për fushatën zgjedhore. Duke patur parasysh partitë politike, si në rastin kur konkurrojnë më vete, apo në kuadër të një koalicioni, kandidatët e listave të tyre

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.04.2021*

shumëemërore, pra të partive politike, siç u përmend më lart, dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, kështu që nuk është propozim për votim. Kalojmë në **pikën 2**. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

***Kush është dakord?***

***Pro:*** 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundra:*** S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

***Kush është dakord?***

***Pro:*** 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundra:*** S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit për miratimin e udhëzuesve për mënyrën e raportimit financiar nga partitë politike, kandidatët e listave shumëemërore dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për fushatën zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë.

***Ju ftoj të votojmë në tërësi projektvendimin?***

***Pro:*** 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundra:*** S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Atëherë mbyllim çështjen e dytë të rendit të ditës. Kalojmë në çështjen e tretë. Kemi në rendin e ditës për shqyrtim...

**Vendimi nr. 18**

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*





**14.04.2021  
Ora 18:51**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi “Për kriteret e caktimit të numrit të grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave, përcaktimin e rregullave për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupit të numërimit për zgjedhjet në Kuvend”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- Ilirjan           **CELIBASHI**           **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- **Komisioni Rregullator:**
- Ilirjana           **NANO**                   **Kryetar**
- Arens            **ÇELA**                   **Anëtar**
- Dritan            **ÇAKA**                  **Anëtar**
- Helga             **VUKAJ**                 **Anëtar**
- Muharrem       **ÇAKAJ**                 **Anëtar**
- Stafi              **KQZ**                   **Y.Merkaj, V.Ballgini, E.Meta**
- Parti            Politike:                   LSI, PSD, PD**

**Znj.I.Nano:** Kalojmë në çështjen e tretë të rendit të ditës. Kemi në rendin e ditës për shqyrtim projektvendimin “Për kriteret e caktimit të numrit të grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave, për caktimin e rregullave për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupit të numërimit për zgjedhjet në kuvend të datës 25 Prill 2021”. Do të ftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të prezantonte projektaktin dhe relacionin, zoti Merkaj!

**Z. Y. Merkaj:** Neni 20 i Kodit Zgjedhor, parashikon kompetencën e Komisionit



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.042021*

Rregullator për miratimin e rregullave të detajuara për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, detyrat e administratës zgjedhore dhe procedurat që zbatohen në zgjedhje. Gjithashtu referuar paragrafit 4, të nenit 12, Komisioni Rregullator është organi kompetent për miratimin e akteve me karakter normativ në fushën e zgjedhjeve dhe vendosjen e rregullave për zgjedhjet. Neni 95 pika 5 e Kodit Zgjedhor parashikon kompetencën e KQZ-së për përcaktimin me akt normativ për kriteret për numrin e grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave. Referuar dispozitave të më sipërme është hartuar ky projektvendim. Qëllimi i këtij projektvendimi, është detajimi i kriterëve për caktimin e numrit të Grupeve të Numërimit të Votave për çdo Vend të Numërimit të Votave, përcaktimin e rregullave për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të Grupit të Numërimit të Votave. Projektvendimi përmban 3 krahë dhe 12 nene. Krahë I përmban 3 nene, qëllimin, e parimet të përgjithshme për krijimin e GNV-ve, afatin e KZAZ-së për caktimin e numrit të grupeve të numërimit të votave në rang KZAZ-je si dhe rregullat për numërtimin e GNV-ve. Krahë II trajton kriteret dhe procedurat që ndjek KZAZ për emërimin e anëtarëve të GNV-ve. Përmban 8 nene dhe trajtojnë papajtueshmërinë me detyrën e anëtarit të GNV-së, kushtet për emërimin e anëtarit të GNV-së, afatet për paraqitjen e propozimeve nga partitë politike, afati për emërimin e anëtarëve të GNV-ve, procedurën e zgjedhjes për numëruesin e parë dhe sekretarin e GNV-ve, zëvendësimin dhe procedurën e shortit për zëvendësimin e tyre dhe plotësimin e vakancës së krijuar. Krahë III trajton hyrjen në fuqi dhe ankimimin. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zoti Merkaj! Fillojmë diskutimet në parim lidhur me projektvendimin. Parapkrakisht, personalisht do të thoja që është një akt shumë i rëndësishëm për shkak se proceset që janë duke u zhvilluar në kuadër të ditës së zgjedhjeve dhe më pas të procesit të numërimit të votave kërkojnë një rregullim të detajuar lidhur me grupet e numërimit, rregullat për ndarjen e detyrave të tyre,

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.042021*

zëvendësimin e anëtarëve të grupeve të numërimit. E gjithë ky rregullim në funksion të një procesi të shpejtë, të drejtë dhe transparent. Kolegë nëse keni diskutime në parim lidhur me projektin, përfaqësues të subjekteve zgjedhore nëse kanë diskutime në parim me projektin? Nëse jo, kalojmë në votimin në parim të projektvendimit .

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundra: S'ka***

***Miratohet në parim!***

Vijojmë nen për nen.

Kreu I të përgjithshme neni 1, qëllimi.

Ky vendim ka për qëllim të detajojë kriteret për caktimin e numrit të Grupeve të Numërimit të Votave për çdo Vend të Numërimit të Votave, përcaktimin e rregullave për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të Grupit të Numërimit të Votave në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Propozime, diskutime, komente? Nëse jo, kalojmë në votim të nenit 1, qëllimi.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundra: S'ka***

***Miratohet!***

Neni 2, Parime të përgjithshme.

1. Numri i Grupeve të Numërimit të Votave, të cilat angazhohen në të njëjtën kohë për numërimin e votave në VNV nuk mund të jetë më pak se tre dhe me shumë se dhjetë.
2. KZAZ-ja cakton me vendim numrin e GNV-ve që do të numërojnë votat në rang ZAZ-je.
3. Anëtarët e GNV-së emërohen nga KZAZ-ja.
4. Çdo grup numërimi përbëhet nga numëruesi i parë, sekretari dhe 2 anëtarë.

*Zbardhi materialin audio*

*Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.042021*

5. Një grup numërimi numëron jo më pak se 5 dhe jo më shumë se 10 qendra votimi. Diskutime për këtë nen? Nëse nuk ka, kalojmë në votim.

***Kush është dakord me nenin 2?***

***Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundra: S'ka***

***Miratohet!***

Neni 3, Caktimi i numërit të Grupeve të Numërimit të Votave.

1. KZAZ-ja, si rregull, jo më vonë se 13 ditë para ditës së votimit cakton me vendim numrin e Grupeve të Numërimit të Votave që do të numërojnë votat në rang ZAZ-je për cdo tavolinë numërimi. Për caktimin e numrit të GNV-ve, KZAZ-ja përdor Modelin–Tip të miratuar me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

2. KZAZ-ja i numërton GNV-të me numër rendor rritës. Numri i fundit rendor është gjithmonë numër çift.

3. Grupi i dytë i Numërimit të Votave fillon numërimin e votave, menjëherë pas përfundimit të procesit nga Grupi i parë i Numërimit të votave.

4. Grupet e dyta të Numërimit të Votave rrinë në gadishmëri dhe me vendim të KZAZ-së zëvendësojnë menjëherë grupet e para, edhe në rastet kur grupet e para ndërpresin punën pa shkaqe të përligjura.

5. Nëse nuk është e nevojshme, grupet e dyta nuk futen në punë.

Fillojmë diskutimin për këtë nen nëse ka? Nëse jo, kalojmë në votimin e nenit 3.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundra: S'ka***

***Miratohet neni 3!***

Kalojmë në KREU II, emërimi i anëtarëve të grupeve të numërimit. Neni 4, Papajtueshmëritë me detyrën e anëtarit të GNV-së.

Anëtari i Grupit të Numërimit të Votave nuk mund të jetë:

a. deputet ose kandidat për deputet në Kuvend;

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.042021*

- b. kryetar i njësisë së qeverisjes vendore;
- c. ushtarak, punonjës i strukturave të Policisë së Shtetit ose Shërbimit Informativ Shtetëror;
- d. anëtar i një grupi tjetër numërimi.

Ka diskutime për këtë nen ose propozime, nëse jo kalojmë në votimin e nenit e 4.

***Kush është dakord?***

***Pro:*** 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundra:*** S'ka

***Miratohet!***

Neni 5, Kushtet për emërimin e anëtarit të GNV-së.

Anëtar i Grupit të Numërimit të Votave mund të emërohet çdo person që plotëson kushtet e mëposhtme:

- a. gëzon të drejtën për të qenë zgjedhës;
  - b. ka arsim të lartë;
  - c. është me vendbanim brenda zonës zgjedhore përkatëse;
  - d. nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
  - e. ndaj tij nuk është marrë masë disiplinore në proceset zgjedhore të mëparshme.
- Keni kolegë ndonjë diskutim? Nëse jo, kalojmë në votimin e nenit 5.

***Kush është dakord me këtë propozim?***

***Pro:*** 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundra:*** S'ka

***Miaratohet!***

Neni 6, Paraqitja e propozimeve nga partitë politike.

1. KZAZ-ja, njofton me shkrim partitë politike të cilat kanë të drejtë të propozojnë anëtarë të GNV-ve, për numrin e GNV-ve që do të ngrihen dhe u kërkon të dorëzojnë propozimet për emërimin e anëtarëve të GNV-ve, të paktën 12 ditë para ditës së zgjedhjeve.

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.042021*

2. Propozimet për dy nga anëtarët e Grupeve të Numërimit bëhen nga partitë politike, të cilat kanë propozuar Kryetarin dhe Zv. kryetarin e KZAZ-së.
3. Propozimet për anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve bëhen nga partitë politike që përcaktuara me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
4. Propozimet për anëtarë të GNV-ve i paraqiten KZAZ-së. Partitë politike të cilat kanë të drejtë të propozojnë anëtarë të GNV-vë mund t'iu delegojnë të drejtën e propozimit degëve të tyre lokale. Propozimet për çdo anëtar të GNV-së shoqërohen me dokumentet e mëposhtme:
  - a. Çertifikatë personale; (mundësuar edhe nga e-albania)
  - b. Fotokopje e letërnjoftimit;
  - c. Kopje e noterizuar e diplomës së shkollës së lartë.Çelimi diskutimin për këtë nen. Po zoti Çaka!

**Z. D. Çaka:** Nuk është se kam ndonjë propozim sepse besoj se është thjesht çështje e unifikimit, aty ku është “zëvendëskryetari” tek pika e 2, të bëhet “nënkryetari” referuar edhe unifikimit me terma të Kodit Zgjedhor dhe vet aktit që është sjellë për propozim.

**Znj. I. Nano:** Në rregull, të kihet parasysh nga administrata gjatë zbardhjes. Nëse nuk ka propozim tjetër, kalojmë në votimin e nenit 6.

**Kush është dakord me nenin 6?**

**Pro:** 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

**Miratohet!**

Neni 7, Emërimi i anëtarëve të Grupeve të Numërimit të Votave.

1. KZAZ jo më vonë se dhjetë ditë ditë para datës së zgjedhjeve emëron anëtarët e Grupeve të Numërimit të Votave pasi i gjen ato në përputhje me kushtet dhe kriteret e parashikuara në nenin 4 dhe 5 të këtij vendimi.

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.042021*

2. Për emërimin e anëtarëve të GNV-ve, KZAZ-ja përdor Modelin Tip “Për emërimin e anëtarëve të Grupeve të Numërimit të Votave”, miratuar me Vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Kemi ndonjë diskutim, propozim, pyetje? Jo. Kalojmë në votimin e nenit 7.

***Kush është dakord me këtë propozim?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundra: S’ka***

***Miratohet!***

Neni 8, Procedura e zgjedhjes për numëruesin e parë dhe sekretarin e GNV-ve. KZAZ-ja emëron numëruesin e parë dhe sekretarin e Grupeve të Numërimit sipas procedurës së mëposhtme:

- a) Partia politike, e cila ka propozuar nënkryetarin e KZAZ-së, ka të drejtën të paraqesë propozime për numëruesin e parë të grupeve “tek” të numërimit të votave dhe sekretarin e grupeve “çift” të numërimit të votave.
- b) Partia politike, e cila ka propozuar kryetarin e KZAZ-së, ka të drejtën të paraqesë propozime për numëruesin e parë të grupeve “çift” të numërimit të votave dhe sekretarin e grupeve “tek” të numërimit të votave.
- c) Anëtari i tretë dhe i katërt i Grupeve të Numërimit emërohen nga propozimet e partive politike, të përcaktuara me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Diskutime? Nuk ka! Atëherë kalojmë në votimin e nenit 8.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundra: S’ka***

***Miratohet!***

**Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.04.2021*

**Znj. I. Nano:** Neni 9. Zëvendësimi i anëtarëve të Grupit të Numërimit.

1. Në rast se, një parti politike nuk paraqet propozim brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 1 të nenit 6 të këtij vendimi, KZAZ-ja me vendim cakton anëtarët zëvendësues.
2. Partitë politike, të cilat me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve kanë të drejtën të paraqesin propozimin për anëtarin e tretë ose të katërt të GNV-ve dhe nuk kanë anëtarë në KQV, humbasin të drejtën të paraqesin anëtarë të GNV-ve nëse nuk respektojnë afatin e parashikuar në pikën 1 të nenit 6 të këtij vendimi.
3. Anëtarët zëvendësues caktohet me short ndërmjet anëtarëve të KQV-ve që i përkasin të njëjtës parti politike në Zonën e Administrimit Zgjedhor.
4. Në rast se nuk është i mundur plotësimi i numrit të anëtarëve të Grupit të Numërimit të Votave, ai funksionon me jo më pak se dy anëtarë. Kemi ndonjë diskutim, koment apo propozim konkret për nenin 9? Nëse jo kalojmë në votimin e nenit 9.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundra: S'ka***

Me 5 vota pro miratohet.

Neni 10. Procedura e shortit për zëvendësimin e anëtarëve të GNV-ve.

Anëtari zëvendësues i GNV-ve, caktohet nga KZAZ-ja, mbi bazën e rezultatit të shortit, të hedhur sipas kësaj procedure:

- a. Sekretari i KZAZ-së për zgjedh të gjithë anëtarët e KQV-ve të cilët plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në nenin 4 dhe në nenin 5, të këtij vendimi.
- b. Anëtarët e KQV-ve renditen, në mënyrë sasiore, në lista sipas partive politike të cilat i kanë propozuar.
- c. Çdo emri, të renditur në secilën listë, i vendoset nga një numër rendor rritës, duke filluar nga 01.

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.04.2021*

d. Në një enë transparente, vendosen shirita letre ku janë shënuar numrat rendor që i korrespondojnë çdo anëtari të KQV-së të partisë politike përkatëse të renditur në listë.

e. Kryetari i KZAZ-së tërheq shirita letre në numër të barabartë me numrin e anëtarëve të GNV-ve që mungojnë.

f. Anëtari i KQV-së, i emëruar me propozim të partisë politike, për të cilën hidhet shorti, të cilit i korespondon numri rendor i shënuar në shiritin e letrës së tërhequr, caktohet anëtar i Grupit të Numërimit.

g. Në rast se partia politike, e cila nuk ka paraqitur propozime për anëtar të GNV-ve dhe nuk ka anëtar në KQV i përket partive të shumicës parlamentare. Shorti hidhet ndërmjet anëtarëve të KQV-së, që i përkasin partisë së dytë të shumicës parlamentare e cila ka propozuar anëtar në KQV.

h. Në rast se partia politike, e cila nuk ka paraqitur propozime për anëtar të GNV-ve dhe nuk ka anëtar në KQV i përket partive të opozitës parlamentare. Shorti hidhet ndërmjet anëtarëve të KQV-së, që i përkasin partisë së dytë të opozitës parlamentare, e cila ka propozuar anëtar në KQV. Neni i gjatë procedurë shorti, kush ka ndonjë diskutim? Po zonja Vukaj.

**Znj. H. Vukaj:** Atëherë për sa lexuat zonja Nano, në nenin 10 Procedura e shortit për zëvendësimin e anëtarëve të GNV-së. Në renditje të pikave gjëj më vend të propozoj, por njëkohësisht duke argumentuar faktin që i shoh të tepërta në uniformitetin e të gjithë kësaj dispozite dy pikat “g” dhe “h”, të cilat renditen në fund të kësaj dispozite. Pasi të gjitha pikat më sipër e shtjellojnë më së miri përcaktimin dhe procedurën e shortit që bëhet për zëvendësuesit e anëtarëve të GNV-ve. Kështu që propozimi im ka të bëjë me qënien në masë deri në pikën “f”, të kësaj dispozite dhe të mbetet po aty dispozita duke hequr dispozitat “g” dhe “h”, si të panevosjshme ose tejet të detajuara ose tejet jashtë kontureve të nevojshme të një dispozite, faleminderit.

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.04.2021*

**Znj. I. Nano:** Faleminderit, kolegë kemi ndonjë koment lidhur me propozimin ose ndonjë propozim tjetër? Nëse jo votojmë propozimin e zonjës Vukaj për heqjen e shkronjës “g” dhe “h” nga neni 10 i këtij projektvendimi.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S’ka

Me 5 vota miratohet.

Neni 11. Plotësimi i vakancës.

1. Kur vendi i një anëtari të Grupit të Numërimit mbetet vakant gjatë procesit të numërimit të votave, partia politike e cila kishte propozuar anëtarin, paraqet menjëherë propozimin e ri.
2. Nëse partia politike përkatëse nuk paraqet propozimin për plotësimin e vendit të mbetur vakant, GNV vazhdon numërimin kur anëtarë në detyrë nuk janë më pak se dy.
3. Nëse nga vakancat e krijuara GNV-ja mbetet me më pak se dy anëtarë, për plotësimin e vakancave KQZ-ja zbaton procedurat e shortit të përcaktuara në nenin 10 të këtij vendimi. Komente diskutime propozime? Nëse jo kalojmë në votimin e nenit 11 Plotësimin e vakancës.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S’ka

Me 5 vota pro miratohet.

**Kreu III** Hyrja në fuqi

Neni 12 Hyrja në fuqi dhe ankimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.04.2021*

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

***Kush është dakord me nenin 12?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundra: S'ka***

Me 5 vota pro miratohet.

Atëherë, kemi miratuar në parim nen për nen projektvendimin. Është momenti ta votojmë në tërësi duke pasur parasysh edhe ndryshimet e propozuar dhe të miratuara.

***Kush është dakord në tërësi me projektvendimin?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundra: S'ka***

Me 5 vota pro Komisioni Rregullator sapo ka miratuar vendimin "Për kriteret e caktimit të numrit të Grupeve të Numërimit për çdo Vend të Numërimit të Votave, përcaktimin e rregullave për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupit të numërimit për zgjedhjet në Kuvend të datës 25 Prill 2021".

**Vendim nr. 19**

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



**JASHTË RENDIT DITËS**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

• **Komisioni Rregullator:**

1.Illirjana NANO Kryetar

2.Arens ÇELA Anëtar

3.Dritan ÇAKA Anëtar

4.Helga VUKAJ Anëtar

5.Muharrem ÇAKAJ Anëtar

• **Stafi KQZ Y.Merkaj, V.Ballgjini, E.Meta**


**Parti Politike: PSD, LSI**

*Znj. I. Nano:* Atëherë çështjet e rendit të ditës përfunduan, kemi miratuar 3 projektakte. Ndërkohë në fillim të mbledhjes kanë kërkuar fjalën për çështje jashtë rendit të ditës, së pari zonja Vukaj dhe më tej zoti Çakaj. Zonja Vukaj për ju fjala.

*Znj. H.Vukaj:* Faleminderit, në fakt nuk është thjesht një çështje jashtë rendit të ditës, por do të thoja referuar fenomenit. Në kuptimin figurativ është një piskamë ligjore dhe shkon përtej ligjores mendoj pasi fenomeni jo vetëm është kriminal, por tejet i rrezikshëm dhe në dukje apo në thelb ky fenomen po tenton apo do të japë efektet e minimumit të këtij procesi ndoshta ditën e zgjedhjeve, ndoshta i ka dhënë apo pas ditës së zgjedhjeve. Më lejoni ta shtjelloj, jo vetëm në aspektin civil pra si qytetar i këtij vendi, si banuese e kryeqytetit, por edhe në rolin e anëtarit të Komisionit Rregullator një nga organet apo instrumentet, i cili në 6 muaj pune

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.04.2021*

voluminoze, intensive dhe shumë të denjë ka miratuar, ka projektuar dhe miratuar akte të cilat janë përpjekur që të krijojnë standartin e barazisë së palëve, standartin e garancisë së procesit zgjedhor dhe një herësh standartin e moscënimit të votës dhe ruajtjes së fshehtësisë së saj. Më vjen keq kolegë t'ju them, por kjo tashmë dëshmon që është cënuar dhe puna jonë është pothuajse e denigruar, ose më falni e pëçutnuar si në aspektin ligjor ndoshta apo më tej. Do ju tregoj një dokument, i cili qarkullon mediatikisht dhe kjo është e dhimbshme, ku unë Helga Vukaj, me numër rendor "X", me numrin tim të identitetit me të dhëna të tjera të miat personale dhe gjeneraliste, ku më del qartë atësia, datëlindja, qendra e votimit, numri i telefonit nëse jam emigrante apo jo... Jam person i sigurt apo jo?! Kë kam patronazhist dhe patronazhisti im që këtu si në aspektin njerëzor, por edhe më tej, më kujton dikaturën në fakt, ku të parët e mi përndiqeshin nga fuksi i lagjes, apo përndjekësi i lagjes me një qëllim të caktuar politik. Mos vallë jemi kthyer në vitet 90?! Kjo është e tmerrshme, në qoftëse vërtet po ndodh, dhe siç rezulton po ndodh! Ku Rezart Fetollari mua më përndiqka të nderuar! Më përndiqka dhe abuzoka me të dhënat e mia, por ky person nuk e bën i vetëm këtë, sepse nuk ka potencialin ti ketë të dhënat e mia. Ky person të dhënat e mia absolutisht i ka siguruar në bashkëpunim të mekanizmave institucional ndërveprues, në këtë katrahurë ose në këtë krim zgjedhor. E dhëna ime si ID nga administrohet? Administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Pra më bën të mendoj që bashkëpunëtor i parë qenka Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Se ku unë jam punësuar më bën të mendoj që Drejtoria e Tatimeve dhe Sigurimeve Shoqëror qenka institucioni tjetër bashëveprues në këtë krim zgjedhor. Të dhëna të tjera, numri im i telefonit, më bën të mendoj që kompania private ku unë i besoj disa të dhëna të tjera, më paska ekspozuar numrin tim të telefonit. Por më bën të mendoj që përtej kësaj, kontigjentët hipernetike mund të më sulmkan në çdo kohë.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.04.2021*

Atëherë ku qëndron garancia në aspektin njerëzor dhe për më tepër në aspektin zgjedhor?! Zero të nderuar! Çfarë është bërë deri tani nga organet të cilat kanë dijeni sepse ziejn mediatikisht kjo çështje? Të prekur gazetarët, sepse janë edhe vetë pjesë e kësaj liste ku ndihen të cënuar dhe të dhunur në aspektin e abuzimit mbi të dhënat e tyre. Analizojnë, diskutojnë dhe nga ana tjetër absolutisht venë gishtin tek manipulimi i këtyre të dhënave për ndikimin mbi procesin zgjedhor. Atëherë më lind natyrshëm pyetja, çfarë është bërë deri tani me këtë çështje? Organet përgjegjëse ligj zbatuese ku janë deri tani? Kjo më impakton dhe më bën të vë theksin për shkak të ndikimit në procesin zgjedhor dhe të punës që kemi bërë deri tani të nderuar! Kështu që dua zoti sekretar i përgjithshëm, meqënëse në mungesë të zoti Celibashi, dua ti adresosh, di që ende nuk është çuar shkresa për Prokurorin e Përgjithshëm, shkresa ku ai duhet të na informojë me imtësi se çfarë është bërë më kallëzimet penale dhe më vjen keq për këtë! Dua ti adresohesh për prezencë këtu në këtë sallë, Drejtorit të Përgjithshëm të Gjëndjes Civile, Drejtueses së E-Albania e cila mban përgjegjësi, Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave të na raportojë urgjent se ç'bëhet dhe cilat janë përgjegjësitë. Avokates së Popullit se çfarë ka evidentuar deri tani me impaktin, sepse impakti nuk është vetëm ky, impakti është edhe post zgjedhor. Çfarë do të thotë kjo? Që post zgjedhor, në atë listë dhe në atë përmbajtje është bërë një ndasi klasore. Që do të thotë, aty njerëzit janë ndarë kush voton PS, kush voton PD, kush voton LSI dhe kështu me rradhë dhe post faktum. Post datës 25 në varësi të zgjedhjeve, kush nuk ka votuar PS mbetet kontigjent që mund të sulmohet. Pra, do të thotë që ti vërsulen tatimet, të mos marrin shërbimet e duhura në sportelet e shërbimeve publike dhe kështu me rradhë. Pra, nuk është vetëm ashtu siç duket një e dhënë statistikore në letër me të cilën në mënyrë sportive ne po e kalojmë nëpër duar apo po e diskutojmë, është përtej kësaj! Ndaj theksi përveç organeve që renditëm duhet t'i drejtohet dhe t'i



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.04.2021*

adresohet me shkresë dhe SPAK-ut, i cili duhet të kishte reaguar deri tani, sepse nuk është çështje që kërkon hetim të thelluar, por është çështje që dalin përgjegjësitë ashtu si kundër unë i rendita më lart. Pra, bashkëpunimi nga secila nga këto struktura publike dhe jopublike, për të kaluar të dhënat e mija. Të gjitha këto janë kriminale! Të gjitha këto duhet patjetër të kenë një përgjigje përpara datës 25, sepse post datës 25 nuk kanë asnjë efekt. Ato sfontimet jo po kujt i përket kompetenca, jo po është e imja, jo po e jotja, si kundër u procedua në zgjedhjet e mëparshme. Në dosjen 184, e cila pati një efekt pothuajse zero për publikun në momentin kur çështja shkoj drejt sheshimit apo drejt asgjesimit në thonjëza, për shkak të mungesës së kompetencave. Faleminderit zoti Merkaj pres feedback menjëherë dhe dua që shkresat të nisen urgjent nesër, sepse është një çështje që është shumë sensitive, faleminderit!

**Znj. I .Nano:** Zoti Merkaj, ju në seancën e kaluar, zonja Vukaj bëri një kërkesë për t'u drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm me shkresë. Ndërkohë është një kërkesë e ripërsëritur, po ndërkohë edhe për institucione të tjera. Keni diçka ju lutem lidhur me këtë?

**Z. Y. Merkaj:** Po, pas kërkesës që bëri zonja Vukaj në mbledhjen e kaluar, i'a transmetova Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i cili i'u drejtua me shkresë Prokurorit të Përgjithshëm në datën, 11.04.2021.

**Znj. I .Nano:** Dakord, faleminderit!

**Z. Y. Merkaj:** Këtë shkresë i'a kam bërë me dije dhe zonjës Vukaj.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.04.2021*

**Znj .I .Nano:** Po, faleminderit.

**Znj. H. Vukaj:** Sa për sqarim, shkresa nuk përcillte atë çfarë unë kam kërkuar, por përcillte vetëm një të dhënë statistikore. Pra i kërkohej Prokurorit të Përgjithshëm se sa është numri i kallëzimeve. Numri i kallëzimeve pothuajse është i ekspozuar në çdo media se sa është deri tani, sepse janë forcat politike dhe subjektet e interesuara që e kanë ekspozuar dhe kjo statistikë nuk na duhet. Kërkesa që unë bëra i referohej se çfarë është bërë me këto kallzime deri tani dhe impaktimi që do të japë Prokurori i Përgjithshëm me veprimtarinë e tij ose me ndërhyrjen e tij?! Efekti post, nuk është i nevojshëm.

**Znj .I .Nano:** Faleminderit, zoti Çakaj ka kërkuar fjalën për çështje jashtë rendit të ditës, po zoti Çakaj!

**Z. M. Çakaj:** Po, faleminderit e nderuar! Shkurtimisht sepse besoj e tha në mënyrë shterruese rëndësinë dhe rrezikshmërinë e asaj çka është ekspozuar këto ditë dhe gjerësisht në media. Shkurtimisht do të them vetëm kaq edhe unë pata kureshtjen e gjeta atë patronazhistin tim, Edjus Pelinku quhet. Totalisht i paaftë se ka zbuluar unë jam 44 vjeç, kam rreth 26 vjet që votoj nuk e ka zbuluar akoma as se për kë votoj un, ose potencialisht mund të votoj. Por as për familjarët e mi nuk e ka zbuluar akoma se për kë votojnë. Kështu që në këtë kontekst me detyrën që i është ngarkuar është i paaftë por, fatkeqësisht duhet të mbajë përgjegjësi penale ai dhe të gjithë ata që denoncoi zonja Vukaj pasi neni 47 i Kodit Zgjedhor, parashikon se lista e zgjedhësve nxirret nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile. Neni 4, parashikon që përpunimi, ndryshimi, modifikimi, shtesa, apo heqja e emrave apo të dhënave të tjera nga lista jashtë Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile dhe në





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.04.2021*

kundërshtim me procedurat e parashikuara në këtë ligj përbën vepër penale dhe dënohet sipas nenit 248 të Kodit Penal. Në rastin konkret, ajo çfarë është publikuar në media është as më pak as më shumë lista e zgjedhësve të qytetit të Tiranës. Që do të thotë kemi të bëjmë me një përpunim të listës së zgjedhësve, pra është e hapur vepër penale, kështu që unë i bashkohem thirrjes së zonjës Vukaj për t'ju drejtuar pra urgjentisht, Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve ti drejtohet të bëj dhe kallëzimin kryesisht lidhur me këtë thyerje të Kodit Zgjedhor. Kjo ishte çështja e parë. Çështja e dytë ka më shumë një karakter sensibilizues, e kemi ndjekur vazhdimisht në media por dhe nga qytetarë të ndryshëm, qoftë edhe njerëz apo të njohurit tanë që na takojnë lidhur me mënyrën e votimit apo vlefshmërinë e votës. Besoj se KQZ ka bërë një punë të mirë, por mesa duket ka akoma nevojë lidhur me edukimin zgjedhor për mënyrën e votimit. Doja të ndaja shkurtimisht me ju, sigurisht edhe për publikun se në mënyrë të përmbledhur zgjedhësi ka të drejtë dhe vota do të konsiderohet e vlefshme. Nëse zgjedhësi zgjedh ose partinë apo koalicionin e partive politike, ose kandidatin, ose të dy partitë dhe kandidatin të të njëjtit subjekt zgjedhor. Në rast se zgjedhësi shqipëtar do të zgjedhë një parti apo koalicion partish dhe një kandidat të një partie tjetër vota është e pavlefshme. Kështu që ftoj KQZ-në të bëjë një punë më intensive në edukimin për mënyrën e votimit të zgjedhësve shqipëtar, faleminderit.

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zoti Çakaj, nëse nuk kemi çështje të tjera për të diskutuar, para se të mbyll mbledhjen do ta ftoja zotin Merkaj të përcillte shqetësimet e Komisionerit, shqetësimet e ngritura. E deklaroj mbledhjen të mbyllur, natën e mirë.

